VENDIM
Nr. 264, datë 21.10.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 199, DATË 15.8.2025, "PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË 'RENEW' SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ 'PROCREDIT BANK' SH.A."

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2157/10 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.08.2025, mbi kërkesën e shoqërisë 'Renew' sh.p.k për dhënien e autorizimit për barrësimin e kuotave të saj, me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura në favor të 'Procredit Bank' sh.a.",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Renew" sh.p.k

- Shoqëria "Renew" sh.p.k është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet 2 mw në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Ndërsa me vendimin nr. 199, datë 15.8.2025, Bordi i ERE-s, ka miratuar dhënien e autorizimit për barrësimin e kuotave të shoqërisë, me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimeve të lindura në favor të "Procredit Bank" sh.a., duke përcaktuar: 1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë "Renew" sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Procredit Bank" sh.a. (sipas kontratave të kredive datë 19.3.2025). 2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë "Renew" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe. 3. Shoqëria "Renew" sh.p.k duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj. 4. Shoqëria "Renew" sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm. 5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

- ERE me shkresën nr. 2157/4 prot., datë 15.8.2025, njoftoi shoqërinë për vendimin e sipërcituar, dhe i solli në vëmendje mbajtjen në konsideratë të plotësimit të kushteve të lëna në këtë vendim.

- Në kuadër të rakordimit të punës dhe të mbikëqyrjes së kushteve respektive është konstatuar nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar në faqen e QKB-së, se rezulton e publikuar çështja në lidhje me depozitimin e Kontratës së Pengut, datë 19.3.2025 (nr. CN-522054-09-25), ndaj ERE me shkresën nr. 2157/8 prot., datë 25.9.2025, i solli në vëmendje detyrimin që kishte në zbatim të vendimit nr. 199/2025, e si e tillë i kërkoi shoqërisë depozitimin e tij, në mënyrë që të vijojë me rishikimin e kushtit të lënë në zbatim të vendimit.

2. Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën nr. 2157/9 prot., datë 30.9.2025, shoqëria ka sqaruar se ka vijuar me regjistrimin e kontratës së pengut në QKB dhe ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të përditësuar, të datës 25.9.2025.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Duke marrë në konsideratë përcaktimet e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, rezulton i përmbushur kushti i parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi.

- ERE është informuar nëpërmjet shkresës datë 30.9.2025, ku shoqëria ka sqaruar se kontrata e pengut është regjistruar në QKB dhe ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të saj me këtë pasqyrim.

- Në këto kushte, vlerësohet se pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, duhet të shfuqizohet, pasi objekti i saj është përmbushur dhe nuk ka më nevojë për ndjekje të mëtejshme institucionale.

- Gjithashtu, me shfuqizimin e pikës 3 të vendimit të Bordit nr. 199/2025, lind nevoja dhe për ndryshimin e pikës 5 të këtij vendimi nga "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi në "Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi".

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet se pika 3 e vendimit të Bordit të ERE nr. 199, datë 15.8.2025, duhet të shfuqizohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE nr. 199, datë 15.8.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 15.8.2025, ndryshon si më poshtë vijon:

"Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi."

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Renew" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti